



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr. 4728 Prot.

Ballsh, më 26.09.2025

PROJEKT VENDIM
Nr 36 Dt. 26 / 09 /2025
PËR:

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.67 DATË 24.12.2024 "PËR MIRATIMIN E
FINANCIMEVE TË NDARË NË 3-VITE",

Në mbështetje të Ligji nr.139/2015 , datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"nenit 54 shkoronja "f",dhe nenit 55 pika 3, Ligji 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", te ligjit Nr. 9936 date 26-06-2008"Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë"te ndryshuar,vendimit të këshillit bashkiak nr.66 datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve,dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027",si dhe vendimit nr.67 datë 24.12.2024 "Për miratimin e financimeve të ndarë në 3-vite", kryetari i bashkisë i propozon këshillit Bashkiak:

TË MIRATOJ

1.Financimin projekteve të investimeve me afat 3(tre) vjeçar,për projektet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Vlera për vitin 2025	Vlera për vitin 2026	Vlera për vitin 2027	Vlera totale
1	Rikonstruksion i rrugës Ngraçan-Riban	26.000.000	25.000.000	30.000.000	81.000.000
2	Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Kremanar	32.286.527	20.000.000	22.713.473	75.000.000
TOTALI		56.786.527	45.000.000	52.213.473	156.000.000

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale
Aleksander Rama

Dr i Drejtorise se Buriemeve Njerezore ,Juridike dhe funksioneve mbeshtetese : Laureta Saliq

KRYETAR

QERIM ISMAILAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I FINANCES**

Nr. 4728/1 prot

Ballsh, më 26 09 2025

**RELACION
PËR**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.67 DATË 24.12.2024 “PËR MIRATIMIN E
FINANCIMEVE TË NDARË NË 3-VITE”**

Ky ndryshim në vendimin nr.67 datë 24.12.2024 “Për miratimin e financimeve të ndarë në 3-vite”, duke u nisur dhe nga prioritetet e Bashkisë në financimin e projekteve në infrastrukturën rrugore për vitin 2025 dhe dy vitet 2026 dhe 2027, si dhe nga verifikimi në terren u pa e projekteve të parashikuara në buxhetin e bashkisë Mallakastër për vitet 2025-2027, është nevojshme kryerja e punimeve shtesë të volumeve dhe veprave në rrugë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë në qarkullim e mjeteve. Për të arritur këtë objektiv është e nevojshme që për 2 projektet Rikonstruksion i rrugës Ngraçan-Riban dhe Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Kremanar të kemi shtesë të fondeve për vitin 2027, dhe në totalin e parashikuar për vitet 2025-2027.

Konkretisht:

Për rrugën : Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Kremanar financimi për vitin 2027 ishte parashikuar 10.000.000 lekë, bëhet 22.713.473 lekë dhe projekti në total nga 62.286.527 lekë bëhet 75.000.000 lekë.

Për rrugën : Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Kremanar financimi për vitin 2027 ishte parashikuar 16.000.000 lekë, bëhet 30.000.000 lekë dhe projekti në total nga 67.000.000 lekë bëhet 81.000.000 lekë.

Me miratimin e këtyre fondeve aarihen të realizon punimet që këto rrugë kanë nevojë, si në sipërfaqe të asfaltuar, cilësi dhe siguri.

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale
Aleksander Rama

KRYETAR

Qerim ISMAILAJ

